

VENDIM
Nr. 17, datë 13.1.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE
NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 15, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2015/1763, “Për vendosjen e masave kufizuese në kuadër të situatës në Burundi”, të ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2016/1745, (CFSP) 2017/1933, (CFSP) 2018/1612, (CFSP) 2019/1788, (CFSP) 2020/1585, (CFSP) 2021/1826, sipas aneksit 15.”.

b) Aneksi 15 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me aneksin 15 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

ANEKSI 15

VENDIMI I KËSHILLIT (PPJS) 2015/1763 i datës 1 tetor 2015 për masat kufizuese lidhur me situatën e Burundi

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

- (1) Më 16 mars 2015, Bashkimi Evropian përsëriti qëndrimi që ka mbajtur që nga fillimi i krizës në Burundi, se vetëm përmes dialogut që çon në konsensus, në përputhje me Marrëveshjen e Arusha për Paqe dhe Pajtim të vitit 2000 dhe Kushtetutën e Burundit, mund të gjendej një zgjidhje e qëndrueshme politike në interes të sigurisë dhe demokracisë për të gjithë popullin e Burundit.
- (2) Më 18 maj 2015, Këshilli dënoi përpjekjen për grusht shteti në Burundi dhe gjithashtu çdo akt dhune ose abuzimi të rendit kushtetues, nga kushdo qoftë, si dhe shprehu shqetësimin e thellë për situatën në Burundi. Këshilli gjithashtu shprehu vendosmërinë për të marrë të gjitha masat e nevojshme kundër partive burundiane veprimet e të cilave përjetësojnë dhunën dhe pengojnë gjetjen e një zgjidhjeje politike.
- (3) Më 22 qershor 2015, Këshilli shprehu shqetësimin e thellë si për numrin e viktimave ashtu edhe për numrin e rasteve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të raportuara që nga fillimi i krizës, veçanërisht ato abuzime që u atribuohen forcave të sigurisë dhe anëtarëve të Imbonerakure. Këshilli përsëriti gjithashtu se ishte i vendosur të merrte, nëse ishte e nevojshme, masa kufizuese të shënjestruara kundër atyre veprimet e të cilëve mund të kishin çuar ose mund të çonin në akte dhune dhe shtypje dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, dhe/ose mund të pengonin gjetjen e një zgjidhjeje politike brenda kornizës së propozuar nga Bashkimi Afrikan dhe Komuniteti i Afrikës Lindore.
- (4) Më 23 korrik 2015, Bashkimi Evropian shprehu keqardhjen që qeveria e Burundit nuk kishte zbatuar plotësisht vendimet përkatëse të Bashkimit Afrikan dhe Komunitetit të Afrikës Lindore që do të kishin hapur rrugën për zgjidhje të besueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- (5) Këshilli ka mbetur seriozisht i shqetësuar për situatën në Burundi. Në rrethanat aktuale dhe në përputhje me Përfundimet e Këshillit të qershorit 2015, kufizimet e udhëtimit dhe ngrirja e pasurive duhet të vendosen kundër personave, subjekteve ose organeve që minojnë demokracinë ose pengojnë gjetjen e një zgjidhjeje politike në Burundi, duke kryer akte dhune, shtypje ose nxitje të dhunës, kundër personave, subjekteve apo organeve të përfshira në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e veprimeve që shkelin të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ose të drejtën ndërkombëtare humanitare, siç është e zbatueshme, ose akte që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, në Burundi, si dhe kundër personave, subjekteve apo organeve që kanë marrëdhënie me ta.
- (6) Bashkimi Evropian duhet të marrë masa të mëtejshme për të zbatuar masa të caktuara,

MIRATON KËTË VENDIM

Neni 1

1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të parandaluar hyrjen apo kalimin transit përmes territorit të tyre për:

- a) personat fizikë që minojnë demokracinë ose pengojnë gjetjen e një zgjidhjeje politike në Burundi, përfshirë përmes akteve të dhunës, shtypjes apo nxitjes së dhunës;
- b) personat fizikë të përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që shkelin të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ose të drejtën ndërkombëtare humanitare, siç është e zbatueshme, ose që përbëjnë abuzime të rënda me të drejtat e njeriut në Burundi; dhe
- c) personat fizikë të cilët kanë marrëdhënie me personat e përcaktuar në germet (a) dhe (b);

ashtu siç renditen në Shtojcë.

2. Pika 1 nuk detyron një Shtet Anëtar që t'u refuzojë shtetasve të vet hyrjen në territorin e saj.

3. Pika 1 nuk cenon rastet kur një Shtet Anëtar ka një detyrim në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, konkretisht:

- a) si vend pritës i një organizate ndërkombëtare ndërqeveritare;
- b) si vend pritës i një konference ndërkombëtare të thirrur nga, ose nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara;
- c) sipas një marrëveshjeje shumëpalëshe që jep privilegje dhe imunitete; ose
- d) në përputhje me Traktatin e Pajimit të vitit 1929 (Pakti i Lateranit) i nënshkruar nga Selia e Shenjtë (Qytet-Shteti i Vatikanit) dhe Italia.

4. Pika 3 gjën zbatim edhe në rastet kur një Shtet Anëtar është vendi pritës i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE).

5. Këshilli informohet rregullisht në të gjitha rastet kur një Shtet Anëtar jep një përjashtim sipas pikës 3 ose 4.

6. Shtetet Anëtare mund të japin përjashtime nga masat e vendosura sipas pikës 1, kur udhëtimi justifikohet për arsye të një nevoje urgjente humanitare, ose për shkak të pjesëmarrjes në takime ndërqeveritare ose takime të promovuara ose të organizuara nga BE-ja apo të pritura nga një Shtet Anëtar që mban kryesimin e OSBE-së, ku zhvillohet një dialog politik që promovon drejtpërdrejt objektivat e masave kufizuese, duke përfshirë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Burundi.

7. Një Shtet Anëtar që dëshiron të japë përjashtime të përmendura në pikat 6 ose 7 njofton Këshillin me shkrim. Përjashtimi konsiderohet i dhënë përveçse nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit ngrenë një kundërshtim me shkrim brenda dy ditëve pune nga marrja e njoftimit për përjashtimin e propozuar. Nëse një ose më shumë anëtarë të Këshillit ngrenë një kundërshtim, Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të vendosë të japë përjashtimin e propozuar.

8. Kur një Shtet Anëtar, sipas pikave 3, 4, 6 apo 7 autorizon hyrjen ose transitin në territorin e vet të personave të renditur në Shtojcë, autorizimi vlen vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë dhe për personave e interesuar drejtpërdrejtë.

Neni 2

Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që posedohen, zotërohen, mbahen ose kontrollohen nga:

- a) persona fizikë ose juridikë, subjektet apo organet, të cilët minojnë demokracinë ose pengojnë gjetjen e një zgjidhjeje politike në Burundi, përfshirë përmes akteve të dhunës, shtypjes apo nxitjes së dhunës;

- b) persona fizikë ose juridikë, subjekte apo organe të përfshirë në planifikimin, drejtimin apo kryerjen e akteve që cenojnë të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut apo të drejtën ndërkombëtare humanitare, sipas rastit, apo që përbëjnë abuzim të rëndë me të drejtat e njeriut;
- c) persona fizikë ose juridikë, subjekte apo organet, të cilët kanë marrëdhënie me personat fizikë ose juridikë, subjektet apo organet e përcaktuara në germa (a) dhe (b).

ashtu siç renditen në Shtojcë, duhet të ngrihen.

2. Asnjë fond ose burim ekonomik nuk do të vihet në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të personave fizikë ose juridikë, subjekteve apo organeve të renditura në Shtojcë.

3. Autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lëshimin e disa fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, ose vënien në dispozicion të disa fondeve ose burimeve ekonomike, sipas kushteve që i konsiderojnë të përshtatshme, pasi konstatojnë se fondet ose burimet ekonomike në fjalë janë:

- a) të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë të personave fizikë ose juridikë, subjekteve apo organeve të renditura në Shtojcë, dhe familjarëve nën përgjegjësinë e personave të tillë fizikë, duke përfshirë pagesat për ushqim, qira ose hipotekë, ilaçe dhe trajtim mjekësor, taksa, prime sigurimi dhe faturat e shërbimeve publike;
- b) të destinuara ekskluzivisht për pagimin e tarifave të arsyeshme profesionale ose rimbursimin e shpenzimeve të që lidhen me ofrimin e shërbimeve juridike;
- c) të destinuara ekskluzivisht për pagimin e tarifave të shërbimit për mbajtjen apo mirëmbajtjen rutinë të fondeve apo burimeve ekonomike të ngrira; ose
- d) të nevojshme për shpenzime përjashtimore, me kusht që autoriteti përgjegjës përkatës të ketë njoftuar autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare të tjera dhe Komisionin për shkaqet mbi të cilat mendon se duhet të jepet një autorizim specifik, të paktën dy javë para autorizimit;

Shtetet Anëtare në fjalë informojnë Shtete Anëtare të tjera dhe Komisionin për çdo autorizim që japin sipas kësaj pike.

4. Me shmangie nga pika 1, autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare mund të autorizojnë lëshimin e disa fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, kur përmbushen kushtet në vijim:

- a) fondet ose burimet ekonomike janë objekt i një vendimi arbitrazhi të dhënë para datës në të cilën personi fizik ose juridik, subjekti apo organi i përmendur në pikën 1 të renditej në Shtojcë, ose i një vendimi gjyqësor ose administrativ të dhënë në BE, apo i një vendimi gjyqësor të ekzekutueshëm në Shtetin Anëtar në fjalë, para ose pas asaj date;
- b) fondet ose burimet ekonomike do të përdoren ekskluzivisht për të përmbushur pretendimet e garantuara apo të njohura si të vlefshme nga një vendim i tillë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligjet dhe aktet normative në fuqi që rregullojnë të drejtat e personave që kanë pretendime të tilla;
- c) vendimi nuk është në dobi të një personi fizik ose juridik, subjekti apo organi të renditur në Shtojcë; dhe
- d) njohja e vendimit nuk është në kundërshtim me politikën publike në Shtetin Anëtar në fjalë.

Shteti Anëtar i interesuar informon Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin për çdo autorizim të dhënë sipas kësaj pike.

5. Pika 1 nuk ndalon një person fizik ose juridik, objekt apo organ të renditur në Aneks që të bëjë një pagesë sipas një kontrate ose marrëveshjeje të lidhur, ose një detyrimi që ka lindur para datës në të cilën personi fizik ose juridik, subjekti apo organi të futej në të, me kusht që Shteti Anëtar në fjalë të konstatojë që pagesa nuk është marrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një person fizik ose juridik, subjekt apo organ i përcaktuar në pikën 1.

6. Pika 2 nuk zbatohet për kreditimet në llogaritë e ngrira:

- a) të interesave apo përfitimeve të tjera për shkak të këtyre llogarive;

- b) të pagesave për shkak të kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve që janë lidhur ose kanë lindur para datës në të cilën ato llogari janë bërë objekt i masave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2; ose
- c) të pagesave për shkak të vendimeve gjyqësore, administrative ose të arbitrazhit të dhëna në një Shtet Anëtar apo të ekzekutueshme në Shtetin Anëtar në fjalë,

me kusht që çdo interes, përfitime të tjera dhe pagesa të mbeten objekt i masave të parashikuara në pikën 1.

Neni 3

1. Këshilli, duke vepruar me propozimin e një Shteti Anëtar ose të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, krijon dhe ndryshon listën e përcaktuar në Shtojcën.

2. Këshilli ia njofton vendimin e përmendur në pikën 1, bashkë me arsyet e futjes në listë, personit fizik ose juridik, subjektit apo organit përkatës, ose drejtpërdrejt nëse dihet adresa, ose përmes shpalljes së një njoftimi, duke i dhënë personit fizik ose juridik, subjektit apo organit mundësinë që të depozitojë kundërshtime.

3. Kur depozitohen kundërshtime apo paraqiten prova të reja thelbësore, Këshilli rishikon vendimet e përcaktuara në pikën 1 dhe rrjedhimisht informon personin fizik ose juridik, subjektin apo organin përkatës.

Neni 4

1. Shtojca përfshin arsyet për futjen në listë të personave fizikë ose juridikë, subjekteve ose organeve të përmendura në nenin 1, pika 1 dhe nenin 2 pika 1.

2. Shtojca përmban, kur është e mundur, informacionin e nevojshëm për të identifikuar personat fizikë ose juridikë, subjektet apo organet në fjalë. Në lidhje me personat fizikë, ky informacion mund të përmbajë: emrat dhe pseudonimet; datëlindjen dhe vendlindjen; shtetësinë; numrin e pasaportës dhe letërnjoftimit; gjininë; adresën, nëse dihet; dhe funksionin ose profesionin. Në lidhje me personat juridikë, subjektet ose organet, ky informacion mund të përmbajë: emrat; vendin dhe datën e regjistrimit; numrin e regjistrimit; dhe vendin e biznesit.

Neni 5

Me qëllim maksimizimin e ndikimit të masave të përcaktuara në këtë Vendim, BE-ja inkurajon Shtetet e treta që të miratojnë masa kufizuese të ngjashme me ato të parashikuara në këtë Vendim.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas publikimit në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Ky Vendim zbatohet deri më 3 tetor 2016.

Ky Vendim mbahet nën rishikim të vazhdueshëm dhe ripërtërihet apo ndryshohet sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë arritur.

Miratuar në Luksemburg, më 1 tetor 2015.

Për Këshillin
Presidenti
E. SCHNEIDER

SHTOJCA

Lista e personave fizikë ose juridikë, subjekteve apo organeve të përcaktuara në nenet 1 dhe 2

	Emri	Informacioni identifikues	Shkaqet e konstatimit
1.	Godefroid BIZIMANA	Datëlindja: 23.4.1968 Vendlindja: NYAGASEKE, MABAYI, CIBITOKÉ Shtetësia burundase. Nr. i pasaportës: DP0001520	Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Kombëtare, përgjegjës për minimin e demokracisë duke marrë vendime operationale që kanë çuar në një përdorim joproporcional të forcës dhe akteve të shtypjes së dhunshme ndaj demonstratave paqësore që filluan më 26 prill 2015 pas shpalljes së kandidaturës presidenciale të Presidentit Nkurunziza.
2.	Gervais NDIRAKOBUCA alias NDAKUGARIKA	Datëlindja: 1.8.1970 Shtetësia burundase. Nr. i pasaportës: DP0000761	Shefi i Kabinetit të Presidencës, përgjegjës për çështjet që lidhen me Policinë Kombëtare. Përgjegjës për pengimin e kërkimit të një zgjidhjeje politike në Burundi duke lëshuar udhëzime që çuan në përdorim joproporcional të forcës, akte dhune, akte shtypjeje dhe shkelje të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut kundër protestuesve që demonstruan nga 26 prilli 2015 e më tej, pas njohimit të kandidaturës presidenciale të Presidentit Nkurunziza, përfshirë më 26, 27 dhe 28 prill në distriktet Nyakabiga dhe Musaga në Bujumbura.
3	Mathias/Joseph NIYONZIMA alias KAZUNGU	Nr. i Regjistrimit (SNR): O/00064 Shtetësia burundase. Nr. i pasaportës: OP0053090	Oficer i Shërbimit Informativ Kombëtar. Përgjegjës për pengimin e gjetjes së një zgjidhjeje politike në Burundi duke nxitur dhunë dhe akte shtypjeje gjatë demonstratave që filluan më 26 prill 2015 pas shpalljes së kandidaturës presidenciale të Presidentit Nkurunziza. Përgjegjës për ndihmën në trajnimin, koordinimin dhe armatosjen e milicive paraushtarake Imbonerakure, përfshirë jashtë Burundi, të cilët janë përgjegjës për akte dhune, shtypje dhe abuzime të rënda me të drejtat e njeriut në Burundi.
4.	Léonard NGENDAKUMANA	Datëlindja: 24.11.1968 Shtetësia burundase. Nr. i pasaportës: DP0000885	Ish i ngarkuar me Punë i Misioneve të Presidencës dhe ish-gjeneral i ushtrisë. Përgjegjës për pengimin e gjetjes së një zgjidhjeje politike në Burundi duke marrë pjesë në përpjekjen për grusht shteti më 13 maj 2015 për të përmbysur qeverinë e Burundit. Përgjegjës për akte dhune, sulme me granata në Burundi, si dhe për nxitjet e dhunës. Gjenerali Léonard Ngendakumana mbështeti publikisht dhunën si një mjet për të arritur qëllimet politike.

DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2015/1763

of 1 October 2015

concerning restrictive measures in view of the situation in Burundi

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 16 March 2015, the European Union reiterated the position it has taken since the beginning of the crisis in Burundi, that only through dialogue leading to consensus, in compliance with the Arusha Agreement for Peace and Reconciliation of 2000 and the Burundian Constitution, could a lasting political solution be found in the interests of security and democracy for all Burundi's people.
- (2) On 18 May 2015, the Council condemned the attempted coup in Burundi and also any act of violence or abuse of the constitutional order, whoever the perpetrators may be, and expressed its deep concern at the situation in Burundi. The Council also expressed its determination to take all measures necessary against Burundian parties whose actions perpetuate violence and hamper the search for a political solution.
- (3) On 22 June 2015, the Council expressed its deep concern at both the number of victims and the number of cases of serious human rights violations reported since the beginning of the crisis, particularly those abuses attributed to the security forces and to members of the Imbonerakure. The Council also reiterated that it was determined to adopt, if necessary, targeted restrictive measures against those whose actions might have led or might lead to acts of violence and repression and serious human rights violations, and/or might hamper the search for a political solution within the framework proposed by the African Union and the East African Community.
- (4) On 23 July 2015, the European Union regretted that the Burundi government had not fully implemented the relevant decisions of the African Union and the East African Community that would have paved the way for credible and inclusive elections.
- (5) The Council has remained seriously concerned about the situation in Burundi. In the current circumstances and, in line with the Council Conclusions of June 2015, travel restrictions and an asset freeze should be imposed against persons, entities or bodies undermining democracy or obstructing the search for a political solution in Burundi, including by acts of violence, repression or inciting violence, persons, entities or bodies involved in planning, directing, or committing acts that violate international human rights law or international humanitarian law, as applicable, or that constitute serious human rights abuses, in Burundi, as well as persons, entities or bodies associated with them.
- (6) Further action by the Union is needed in order to implement certain measures,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

1. Member States shall take the measures necessary to prevent the entry into, or transit through, their territories of:
 - (a) natural persons undermining democracy or obstructing the search for a political solution in Burundi, including by acts of violence, repression or inciting violence;

(b) natural persons involved in planning, directing, or committing acts that violate international human rights law or international humanitarian law, as applicable, or that constitute serious human rights abuses, in Burundi; and

(c) natural persons associated with those referred to in points (a) and (b);

as listed in the Annex.

2. Paragraph 1 shall not oblige a Member State to refuse its own nationals entry into its territory.

3. Paragraph 1 shall be without prejudice to the cases where a Member State is bound by an obligation of international law, namely:

(a) as a host country of an international intergovernmental organisation;

(b) as a host country to an international conference convened by, or under the auspices of, the United Nations;

(c) under a multilateral agreement conferring privileges and immunities; or

(d) pursuant to the 1929 Treaty of Conciliation (Lateran Pact) concluded by the Holy See (Vatican City State) and Italy.

4. Paragraph 3 shall be considered as applying also in cases where a Member State is host country of the Organisation for Security and Cooperation in Europe (OSCE).

5. The Council shall be duly informed in all cases where a Member State grants an exemption pursuant to paragraph 3 or 4.

6. Member States may grant exemptions from the measures imposed under paragraph 1 where travel is justified on the grounds of urgent humanitarian need, or on grounds of attending intergovernmental meetings and those promoted or hosted by the European Union, or hosted by a Member State holding the Chairmanship in office of the OSCE, where a political dialogue is conducted that directly promotes the policy objectives of restrictive measures, including democracy, human rights and the rule of law in Burundi.

7. A Member State wishing to grant exemptions referred to in paragraph 6 shall notify the Council in writing. The exemption shall be deemed to be granted unless one or more of the Council members raises an objection in writing within two working days of receiving notification of the proposed exemption. Should one or more of the Council members raise an objection, the Council, acting by a qualified majority, may decide to grant the proposed exemption.

8. Where, pursuant to paragraphs 3, 4, 6 or 7 a Member State authorises the entry into, or transit through its territory of persons listed in the Annex, the authorisation shall be strictly limited to the purpose for which it is given and to the persons directly concerned thereby.

Article 2

1. All funds and economic resources belonging to, owned, held or controlled by:

(a) natural or legal persons, entities or bodies undermining democracy or obstructing the search for a political solution in Burundi, including by acts of violence, repression or inciting violence;

(b) natural or legal persons, entities or bodies involved in planning, directing, or committing acts that violate international human rights law or international humanitarian law, as applicable, or that constitute serious human rights abuses, in Burundi; and

(c) natural or legal persons, entities or bodies associated with the persons, entities or bodies referred to in points (a) and (b);

as listed in the Annex, shall be frozen.

2. No funds or economic resources shall be made available directly or indirectly to or for the benefit of the natural or legal persons, entities or bodies listed in the Annex.

3. The competent authority of a Member State may authorise the release of certain frozen funds or economic resources, or the making available of certain funds or economic resources, under such conditions as it deems appropriate, after having determined that the funds or economic resources concerned are:

- (a) necessary to satisfy the basic needs of the natural or legal persons, entities or bodies listed in the Annex and dependent family members of such natural persons, including payments for foodstuffs, rent or mortgage, medicines and medical treatment, taxes, insurance premiums, and public utility charges;
- (b) intended exclusively for the payment of reasonable professional fees and the reimbursement of incurred expenses associated with the provision of legal services;
- (c) intended exclusively for the payment of fees or service charges for the routine holding or maintenance of frozen funds or economic resources; or
- (d) necessary for extraordinary expenses, provided that the competent authority has notified the competent authorities of the other Member States and the Commission of the grounds on which it considers that a specific authorisation should be granted, at least two weeks prior to the authorisation.

The Member State concerned shall inform the other Member States and the Commission of any authorisation granted under this paragraph.

4. By way of derogation from paragraph 1, the competent authorities of a Member State may authorise the release of certain frozen funds or economic resources, provided that the following conditions are met:

- (a) the funds or economic resources are the subject of an arbitral decision rendered prior to the date on which the natural or legal person, entity or body referred to in paragraph 1 was listed in the Annex, or of a judicial or administrative decision rendered in the Union, or a judicial decision enforceable in the Member State concerned, prior to or after that date;
- (b) the funds or economic resources will be used exclusively to satisfy claims secured by such a decision or recognised as valid in such a decision, within the limits set by applicable laws and regulations governing the rights of persons having such claims;
- (c) the decision is not for the benefit of a natural or legal person, entity or body listed in the Annex; and
- (d) recognition of the decision is not contrary to public policy in the Member State concerned.

The Member State concerned shall inform the other Member States and the Commission of any authorisations granted under this paragraph.

5. Paragraph 1 shall not prevent a natural or legal person, an entity or body listed in the Annex from making a payment due under a contract entered into prior to the date on which such natural or legal person, entity or body was listed therein, provided that the Member State concerned has determined that the payment is not, directly or indirectly, received by a natural or legal person, entity or body referred to in paragraph 1.

6. Paragraph 2 shall not apply to the addition to frozen accounts of:

- (a) interest or other earnings on those accounts;
- (b) payments due under contracts, agreements or obligations that were concluded or arose prior to the date on which those accounts became subject to the measures provided for in paragraphs 1 and 2; or
- (c) payments due under judicial, administrative or arbitral decisions rendered in the Union or enforceable in the Member State concerned;

provided that any such interest, other earnings and payments remain subject to the measures provided for in paragraph 1.

Article 3

1. The Council, acting upon a proposal from a Member State or from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy, shall establish and amend the list in the Annex.

2. The Council shall communicate the decision referred to in paragraph 1, including the grounds for the listing, to the natural or legal person, entity or body concerned, either directly, if the address is known, or through the publication of a notice, providing such person, entity or body with an opportunity to present observations.

3. Where observations are submitted, or where substantial new evidence is presented, the Council shall review the decision referred to in paragraph 1 and inform the natural or legal person, entity or body concerned accordingly.

Article 4

1. The Annex shall include the grounds for listing the natural and legal persons, entities and bodies referred to in Article 1(1) and Article 2(1).

2. The Annex shall also contain, where available, the information necessary to identify the natural or legal persons, entities or bodies concerned. With regard to natural persons, such information may include names, including aliases, date and place of birth, nationality, passport and identity card numbers, gender, address if known, and function or profession. With regard to legal persons, entities or bodies, such information may include names, place and date of registration, registration number and place of business.

Article 5

In order to maximise the impact of the measures set out in this Decision, the Union shall encourage third States to adopt restrictive measures similar to those provided for in this Decision.

Article 6

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

This Decision shall apply until 3 October 2016.

This Decision shall be kept under constant review. It shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.

Done at Luxembourg, 1 October 2015.

For the Council
The President
E. SCHNEIDER

ANNEX

List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 1 and 2

	Name	Identifying information	Grounds for designation
1.	Godefroid BIZIMANA	DOB: 23.4.1968 POB: NYAGASEKE, MABAYI, CIBITOKÉ Burundian nationality. Passport number: DP0001520	Deputy Director General of the National Police, responsible for undermining democracy by making operational decisions that have led to a disproportionate use of force and acts of violent repression towards peaceful demonstrations that started on 26 April 2015 following the announcement of the presidential candidacy of President Nkurunziza.
2.	Gervais NDIRAKOBUCA alias NDAKUGARIKA	DOB: 1.8.1970 Burundian nationality. Passport number: DP0000761	Head of Cabinet of the Presidential Administration (Présidence) responsible for matters relating to the National Police. Responsible for obstructing the search for a political solution in Burundi by issuing instructions that led to disproportionate use of force, acts of violence, acts of repression and violations of international human rights law against protestors demonstrating from 26 April 2015 onwards, following the announcement of the presidential candidacy of President Nkurunziza, including on 26, 27 and 28 April in the Nyakabiga and Musaga districts in Bujumbura.
3.	Mathias/Joseph NIYONZIMA alias KAZUNGU	Registration number (SNR): O/00064 Burundian nationality. Passport number: OP0053090	Officer of the National Intelligence Service. Responsible for obstructing the search for a political solution in Burundi by inciting violence and acts of repression during the demonstrations that started on 26 April 2015 following the announcement of the presidential candidacy of President Nkurunziza. Responsible for helping train, coordinate and arm the Imbonerakure paramilitary militias, including outside Burundi, who are responsible for acts of violence, repression and serious human rights abuses in Burundi.
